



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr.734/3 Prot.

Tiranë, më 18.12.2017

V E N D I M

Nr.174, Datë 18.12.2017

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t QARKU SHKODËR "MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE" për periudhën nga data "01.01.2015 deri më datën 30.07.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Shkodër rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për, vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale" të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Shkodër, sipas programit të auditimit nr. 734/1, datë 10.07.2017, i ndryshuar me nr. 734/2, datë 24.07.2017 për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri më datën 30.07.2017

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Shkodër në momentin e auditimit janë **1932 objekte informale** për të cilat janë kryer të gjitha procedurat kualifikuese për legalizim janë përgatitur e printuar lejet e legalizimit prej një periudhe nga 2 deri në 3 vjet por “nuk i janë dhënë qytetarit”, këto dosje janë në administrim nga drejtuesit dhe nuk janë kthyer në arshivë. Në dosje nuk ka asnjë dokumentacion ligjor mbi vonesën e mos dhënies se lejes se legalizimit, duke mos respektuar afatin ligjor në 30 ditë për dhënien proceduesit të lejes së legalizimit, veprime në kundërshtim me nenin 28 “ Dhënia e lejes se legalizimit” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime .

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa me program pune, afate konkrete e me persona përgjegjës, për inventarizimin e dosjeve të përfunduara dhe të pa shpërndara lejet e legalizimit dhe të kryej arkivimin e tyre. Gjithashtu të organizohet puna që praktikatat të tilla të dëmshme mos të përsëriten, duke mbajtur peng qytetarët.

Brenda muajit Janar 2018

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Qarku Shkodër nuk ka dokumentacion shkresor për skualifikimin ose jo të **993 objekteve** të ndërtuara në **zonën historike, arkeologjike apo zonë e mbrojtur**, si dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore në Qarkun e Shkodër. Veprime në kundërshtim me neni 38 “Dhënia e lejes së legalizimit” dhe nenin dhe 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime .

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër në procesin e legalizimit të objekteve informale të dokumentojë në një regjistër të veçantë objektet e ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin, duke informuar në çdo rast Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe të gjitha institucionet e vetëqeverisjes vendore në Qarkun e Shkodër (*Bashkia Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz*) për marrjen e masave për prishje të objekteve të përjashtuara nga procesi i legalizimit dhe ndjekjen permanente të gjendjes tyre e mos lejuar legalizimin e tyre.

Brenda muajit Janar 2018

3. Gjetje nga auditimi: Në **16 raste** “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” i ndryshuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, të marrë masa që për **16 rastet** e konstatuara e në vijim të plotësohet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Në rastin e mos plotësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Industrisë dhe Infrastrukturës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Brenda muajit Janar 2018

4. Gjetje nga auditimi: - Në 6 raste Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër nuk ka respektuar afatin 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8 “Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht”.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa që më plane konkrete, të shqyrtojë kërkesat brenda afatit 60 ditor, duke shqyrtuar praktikën e legalizimit dhe përcaktimin e tyre për vijueshmërinë e procesit apo për shkualifikimin e tyre nga procesi i legalizimit si objekte që nuk plotësojnë kërkesat ligjore.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër në 7 raste nuk disponohet në dosje dokumentacionin që pasqyron periudhën e ndërtimit pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën e ndërtimit dhe objektet e papërfunduara. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: - “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përfutur nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.” si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje".

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, të marrë masa që për 7 rastet e konstatuara që nuk disponojnë dokumentacionin, të pasqyrojë periudhën e ndërtimit pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën ndërtimit. Për këto objekte të papërfunduara, DR Aluizni Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit, të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Brenda muajit Janar 2018

6. Gjetje nga auditimi: Në 57 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi:*

-Në 1 rast me sipërfaqe 115 m², është kryer legalizim i objektet pa respektuar distancat nga brigjet, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së lumit me pak se 100 metrash** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5. VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 4.

-Në 13 raste me sipërfaqe 4575 m², janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët nacionale e Urbane, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës rrugës nacionale e urbane me pak se përcaktimet ligjore prej 25 ml**. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e

ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përfashtimi nga legalizimi”, VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar, Kreu I pika 2/b dhe i ç’fuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”, VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2.

-Në 24 raste, gjithsej për 10791 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, pyll”, zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”

-Në 1 raste objektet i legalizuara është aktualisht **me statusin e territorit publik**. Konkretisht - **dosja nr. 271, datë 04.08.2006; me** Leja e Legalizimit me nr. 87056, datë 06.02. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenet 27 dhe 41 konkretisht: neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit” pika d) Ku përcaktohet: -“*vërtetimin ose certifikatë ne pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. I njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin.*”; neni 41 “Kriteret për legalizimin e shtesave” pika 2 dhe 3 ku përcaktohet: -“*2. Nuk legalizohen, në kuptim të këtij ligji, ndërtimet ose shtesat e ndërtimeve pa leje, të kryera brenda territoreve të shkollave dhe institucioneve të tjera publike.3. Asnjë ndërtim tjetër informal, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, nuk legalizohet brenda këtyre territoreve.*”.

-Në 15 raste objektetet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Liqenit të Shkodrës** veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” ku përcaktohet:

Pika 2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar. Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe VKM me nr. 684, date 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”.

-Në 3 raste objektet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Lumit Buna, në dosje nuk ndodhet plani i menaxhimit të zonës dhe aprovimi i lejes mjedisore, dokumnet ky që i bën të paligjshme këto legalizime**. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” ku përcaktohet:

Pika 2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar. Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe VKM me nr. 682, date 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të lumit Buna territore ligatinore përreth tij ” Pejsazh ujor/tokesor I mbrojtur” (Trajtuar në faqet 26-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Brenda muajit Shkurt 2018

7. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër në 2raste konkretisht Leja e Legalizimit me nr. 92637 datë 06.10.2014 proceduesi P. M. D. dhe Leja e Legalizimit me nr. 94593 datë 25.04.2016 proceduesi A.G.G janë lëshuar në objekt të papërfunduar, veprime në kundërshtim me nenin 2 (pika 1) dhe 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime si dhe ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 i ndryshuar, VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu VI, pika 11 dhe 13.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Brenda muajit Janar 2018

8. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet, Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla nuk ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr.9643, datë 20.01.2006, "Për prokurimin Publik", i ndryshuar dhe nenin 9 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik".

-Për procedurën e prokurimit "*Shërbimi i evidentimit faktik në terren i ndërtimeve pa leje të Qarkut Shkodër*", mungon kërkesa për nevojat dhe vlerën e kërkuar për prokurim nga sektorët përkatës pa përlllogaritur nevojat në mënyrë të qartë e të saktë në këtë fazë pune, duke identifikuar dosjet sipas zonave informale të shtrira dhe të klasifikuara sipas ZK, që do të mbulohen me këtë shërbim është në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Kreu II "Organizimi i prokurimit publik" neni 12.

- Njësia e Prokurimit nuk ka bërë përlllogaritja e fondit limit e cila duhej bazuar në Ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje", VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", si dhe VKM nr. 589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit në terren të objekteve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve dhe dokumentacionit". Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka asnjë informacion analitik mbi numrin faktik dhe gjendjen reale të ndërtimeve pa leje sipas zonave dhe vetëdeklarimeve të bëra nga individët, ndërtimet sipas zonave, për të dhënë një pasqyrë të qartë se sa % janë ndërtimet informale nga sasia totale e ndërtimeve të evidentuara, në mënyrë që të bëhet një përlllogaritje e saktë e fondit limit për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi.

-Nga AK nuk është përcaktuar çmimi i analizuar në bazë të termave të referencave, sipas zërave përbërës të këtij shërbimi, nuk ka asnjë të dhënë për analizën e kostos, përqindjen e fitimit, apo qiraja e përdorimit të ambienteve në DR Aluizni Shkodër apo vendodhje tjetër jashtë institucionit.

-Vlera limit e kontratës është barazvlerësuar me fondin në dispozicion dhe nuk është përlllogaritur në bazë nevojash (sasia dhe çmimi). Nevojat janë numri kateve, që do të mbulohej me shërbimin e kërkuar, i cili do të rezultonte mbi bazën e përcaktimit të një numri dosjesh të vetëdeklarimeve të një apo më shumë blloqeve të ZK mbi bazën e të dhënave të sipërpërmendura, ku do të evidentoheshin katet për çdo objekt sipas llojit.

-Mos përlllogaritja e vlerës limit të kontratës mbi bazën e nevojave të cilat duhet përcaktoheshin si më sipër, është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për

prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, i ndryshuar.

-Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar dhe as dokumentuar në një procesverbal hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 61 të VKM nr. 914, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Kriteret për kualifikim të përcaktuara nga Njësia e Prokurimit nuk janë të plota dhe të qarta, disa prej tyre nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit dhe parimet për konkurrencën e lirë dhe transparencën në procedurat e prokurimit.

8.1.Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa që për të gjitha procedurat e prokurimit që do të kryej, të bëhet kërkesa për nevojat në sasi e vlera nga sektorët përkatës për kryerjen e procedurës prokurimit sipas madhësisë së vlerës, duke u bazuar në nevojat e paraqitura. Njësia e Prokurimit të bëjë përlllogaritjen e fondit limit duke argumentuar qartë edhe saktë, hartimin e fondit limit. Ky proces të shoqërohet me dokumentacion justifikues e argumentues, si dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, të hartohen në përputhje me natyrën, objektin e kontratës, por mbi të gjitha të hartohen në mënyrë të tillë që mos të cenonjë parimet e konkurrencës së lirë dhe transparencën në procedurat e prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit “*Shërbimi i evidentimit faktik në terren i ndërtimeve pa leje të Qarkut Shkodër*”, titullari i AK nuk ka nxjerr urdhër për ngritjen e Njesisë së Prokurimit, veprim në kundërshtim me nenin 56 dhe 57 të VKM nr. 914, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar .

9.1.Rekomandim: Titullari i AK në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa që për të gjitha procedurat e prokurimit, të nxjerri urdhrin përkatës për ngritjen e Njesisë së Prokurimit.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i ankesës shtetasit Pashk Nika administruar në KLSH me nr. 921 prot, datë 31.08.2017, për vonesat e shkaktuara nga ALUIZNI Shkodër në trajtimin e dosjes së tij si dhe mos pajisjen me leje legalizimi rezultoi që:

në Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Shkodër P.K.N. ka bërë 5 aplikime për legalizimin e ndërtimeve informale nga të cilat në momentin e auditimit ka marrë 3 leje legalizimi.

Për dy dosjet e pa shqyrtuara nga DR Aluizni Shkodër, sqarojmë:

1. Dosja nr. 958 date 15.11.2006, objekti informal 1 kat, me funksion jo banesë.

- Procesverbali i konstatimit në terren datë 16.02.2009, nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t.

- Sipas planimetrisë hartuar në datë 29.07.2015, sipërfaqe faktike ndërtimit është 15.6 m².

- Nuk ka Vendim kualifikimit, si dhe nuk ishte paguar tarifa e shërbimit në vlerë 8000 lekë si objekt shërbimi në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”.

2. - Dosja nr. 696 pa datë, objekti informal 1 kat, me funksion banesë, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 161.7 m², trualli në pronësi shtet, pasuria 14/503, vol. 37, fq. 176, zk. 8593, e llojit arë, me sipërfaqe 1250.12 m².

- Procesverbali i konstatimit në terren datë 25.05.2015, nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t.

- Sipas planimetrisë hartuar në datë 29.07.2015, sipërfaqe faktike ndërtimit është 161.7 m².

- Vendimi i kualifikimit nr. 4313 mban datën 14.10.2015, ndërkohë që procesverbali i konstatimit mban datën 25.05.2015.

Sa sipër, nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të ndodhur në dosje në lidhje me procesin e legalizimit, rezulton se nuk janë zbatuar procedurat administrative në përpilimin e akteve të ndërmjetme procedurale sipas afateve ligjore, nuk është respektuar afati prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e Vendimit për kualifikimin ose jo të objektit në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8. Ku përcaktohet se:

“Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht,”

Mungon vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe dokumentacioni për kalim pronësie të truallit.

10.1.Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër në zbatim të detyrimit që ka, të marrë masa dhe ti adresojë qytetarit zgjidhjen sipas procedurave të caktuara, përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të zbatueshëm për ndërtimin pa leje, duke respektuar afatin ligjor për mbajtjen e akteve administrative të ndërmjetme dhe marrjen e vendimit përkatës në zbatim të kërkesave të ligjit.

Nga ana e Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit të marrë masa për të njoftuar qytetarin mbi konkluzionet e verifikimit dhe zgjidhjen e ankesës së administruar në KLSH-it.

Brenda muajit Janar 2018

B. 1. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **4 raste me vlerë 2,310,510 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

a. Në lëshimin e lejes së legalizimit **nr. 93717 datë 07.09.2015 proceduesi L.M.B** me objekt në total prej 2135.5 m², është konstatuar një diferencë dale jashtë lejes së ndërtimit prej 799.9 m². Nga Drejtorisë së ALUIZNI-t Qarku Shkodër nuk është aplikuar penaltet në përputhje e zbatim të nenit 43 “Penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues”, **duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 1,314,275 lekë** (799.9 m² X 32 861 x 5% të marrë sipas çmimit mesatar të miratuar në Udhëzimin e KM nr.2 datë 06.08.2014).

b. Në lëshimin e lejes së legalizimit **nr. 93717 datë 07.09.2015 L.M.B** në kundërshtim me nenin 2 (pika 1) dhe 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime si dhe ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 i ndryshuar, VKM nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu VI, pika 11 dhe 13. Në dosje nuk gjendet vërtetimi nga pushteti vendor i likuidimit të taksës së infrastrukturës, pra nuk ka likuiduar taksën e infrastrukturës për 2135.5 m² në vlerën **90,876 lekë** (2135.5 m² x 8,511 lekë x 0.5%).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e:

a- vlerës **1,314,275 lekë** nga subjekti **L.M.B**, si penalitet i pa llogaritur e pa paguar, në rast refuzimi të kërkohet masë kufizimi në ZVRPP e bashkisë përkatëse.

b- vlerës prej **90,876 lekë** nga subjekti **L.M.B**, si taksë infrastrukture e papaguar, në rast refuzimi të kërkohet masë kufizimi në ZVRPP e bashkisë përkatëse.

Brenda muajit Shkurt 2018

2. Gjetje nga auditimi: - Në lejen e legalizimit **nr.24661 datë 16.10.2015 proceduesi S.D.K** në kundërshtim me nenin 2 (pika 1) dhe 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime si dhe ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 i ndryshuar, VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu VI, pika 11 dhe 13. Ka të legalizuar vetëm 2 kate kur në foto e disponuar janë 3 kate të përfunduara plotësisht, pra ka shmangie të taksës së infrastrukturës për 131.3 m² në vlerën **5,587 lekë** (131.3 m² x 8,511 lekë x 0.5%).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **5,587 lekë** nga subjekti **S. D.K**, si Taksë infrastrukture e papaguar.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit “*Shërbimi i evidentimit faktik në terren i ndërtimeve pa leje të Qarkut Shkodër*”, u konstatua se tarifa e evidentimit në terren të objekteve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje për një kat është përcaktuar 6,990 lekë pa TVSH dhe 8,388 lekë me TVSH, ndërkohë që referuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, pika 2. Tarifa e shërbimit për legalizim, për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe për objektet e dyta, në kuptim të nenit 25, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, të ndryshuar, është 8,000 (tetë mijë) lekë, për çdo kat të ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa në favor të bashkimit të operatorëve fitues për shlyerjen e detyrimit sipas kushteve të kontratës në vlerën 19,451,772 lekë me TVSH, për pasojë **diferenca prej 899,772 lekë** (8,388 lekë çmimi me TVSH i ofruar nga fituesi – 8000 lekë çmimi tavan bashkë me TVSH që nuk duhet kalohej referuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pra 388 lekë X 2,319 njësi (numri i ndërtimeve të evidentuara në terren), **përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

3.1.Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e vlerës prej **899,772 lekë** e përfituar padrejtësisht nga *bashkimi i operatorëve ekonomik “D...-E” shpk & “Z...-06” shpk & “G... Consulting” shpk & “C...E.....C Group” shpk.*

Menjëherë

B.2. TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën 576/9, datë 23.12.2013, “*Rekomandimeve të lëna nga KLSH,*” bazuar në nenin 30 “*Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*” të ligjit nr. 154/2014, “*Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, ka kërkuar që Drejtoria e Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa për të bashkëngjitur parcelave ndërtimore sipërfaqet e poseduara por të pa llogaritura në pagesë, në 50 rastet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH, me sipërfaqe totale 20038 m², llogaritur në vlerë 177,832,630 lekë. Në lidhje me këtë rekomandim Drejtoria Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Shkodër ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme me nr. 144/1, datë 06.02.2014 lënda: “*Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit pas kontrollit të ushtruar në Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër*”, ku citohet se: -në bazë të orientimeve tuaja nuk është kryer asnjë veprim për 50 rastet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të KLSH-së .

1.1. Rekomandim:Drejtoria e Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, të marrë masa për të kryer bashkimin e parcelave ndërtimore sipas sipërfaqeve të poseduara por të pa llogaritura në pagesat e kryera në **50 raste me sipërfaqe totale 20038 m² të llogaritur në vlerë 177,832,630 lekë**, të cilat janë evidentuara në Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH të vitit 2013,

Brenda muajit Maj 2018

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Shkodër nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI^t, Shkodër*), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së trullit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjese përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar. Por këto janë numërtuar si parcelë më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim(*përcaktim hyrje-dalje në parcelë dhe veçim nga pjesa e legalizuar*)për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 8 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 1983 m²* (në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së trullit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale **prej 9,168,147 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.**

- Gjithashtu nga ALUIZNI-t Shkodër jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Shkodër, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë trullin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore .

2.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shpresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Shkodër, duke vënë në dispozicion listën me sipërfaqe të lira, konkretisht për **8 raste** evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 1983 m²* (në total), **me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së trullit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 9,168,147 lekë** (*sipas listës bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Gjetje nga auditmi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –**“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”** si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“ c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive të Qarkut, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 157,528,377 lekë**, pasi nga 5284 leje legalizimi të emetuara dhe të shpërndara nga totali prej 181,216,747 lekë taksë infrastrukture që duhej arkëtuar janë arkëtuar vetëm 23,688,370 lekë, ose 16.2%e totalit .

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Shkodër, vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **vlerën prej 157,528,377 lekë** (sipas listës bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Brenda muajit Janar –Shkurt 2018

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNIT Tiranë dhe Drejtorit Rajonal të ALUIZNI-t Shkodër**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Largim nga puna”**, për këta punonjës:

I. “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 4 punonjës si më poshtë:

- 1. z. E.B**, me detyrë Specialiste në cilësinë e Përgjegjës e Sektorit të Legalizimit në periudhën nga viti 2014 deri 04.10.2016,
- 2. I.SH** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë Hartografisë nga viti 2015 e në vazhdim,
- 3. A.B** specialist për çështjet e pronësisë dhe jurist i Njësisë së Prokurimit,
- 4. F.T** me detyrë specialist, në cilësinë e Përgjegjës e Sektorit të Legalizimit

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit:

- **Në 64 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *konkretisht:*

-**Në 1 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet**, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në ne një distancë prej **buzës së lumit me pak se 100 metrash** veprime këto në

kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5. VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 4;

-në 13 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët nacionale e Urbane ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në ne një distancë prej **buzës rrugës nacionale e urbane me pak se përcaktimet ligjore** veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përfundimi nga legalizimi”, VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar Kreu I pika 2/b dhe i ç’fuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2;

-në 24 raste, gjithsej për 10791 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, pyll”, zona informale këto të pamiratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Trull”

-në 1 rast objekti i legalizuar është aktualisht **me statusin e territorit publik**. Konkretisht **-dosja nr. 271, datë 04.08.2006; me Leja e Legalizimit me nr. 87056, datë 06.02.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenet 27 dhe 41 konkretisht: neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit” pika d) Ku përcaktohet: *“vërtetimin ose certifikatë ne pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. I njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin.”*; neni 41 “Kriteret për legalizimin e shtesave” pika 2 dhe 3 ku përcaktohet: *“2. Nuk legalizohen, në kuptim të këtij ligji, ndërtimet ose shtesat e ndërtimeve pa leje, të kryera brenda territoreve të shkollave dhe institucioneve të tjera publike.3. Asnjë ndërtim tjetër informal, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, nuk legalizohet brenda këtyre territoreve.”*

-në 15 raste objektetet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Liqenit të Shkodrës** veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” ku përcaktohet:

Pika 2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe VKM me nr. 684, date 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”.

-në 3 raste objektetet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Lumit Buna, në dosje nuk ndodhet plani i menaxhimit të zonës dhe aprovimi i lejes mjedisore.** veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr.

9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” ku përcaktohet:

Pika 2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar. Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe VKM me nr. 682, datë 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të lumit Buna territore ligatinore përreth tij ” Pejsazh ujor/tokesor I mbrojtur”

-në 2raste konkretisht Leja e Legalizimit me nr. 92637 datë 06.10.2014 proceduesi P.M.D dhe Leja e Legalizimit me nr.94593 datë 25.04.2016 proceduesi A.G.G janë lëshuar në objekt të papërfunduar, veprime në kundërshtim me nenin 2 (pika 1) dhe 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime si dhe ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 i ndryshuar, VKM nr.280,datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu VI, pika 1 dhe 13

- në 7 raste nuk disponohet në dosje mos dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën e ndërtimit dhe objektin papërfunduar**, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: - “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përfutur nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.” si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje

- nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Shkodër nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI^t, Shkodër), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (brenda/jashtë vijës së verdhë), për efekt pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjese përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultojnë në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen-plan, planimetri)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 8 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 1983 m² (në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 9,168,147 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

-Nuk kanë përlogaritur fondin limit i cili duhej bazuar në Ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje”, VKM nr. 860, datë 10.12.2014“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, si dhe VKM nr. 589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit në terren të objekteve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve dhe dokumentacionit”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka asnjë informacion analitik mbi numrin faktik dhe gjendjen reale të ndërtimeve pa leje sipas zonave dhe vete deklarimeve të bëra nga individët, ndërtimet sipas zonave, për të dhënë një pasqyrë të qartë se sa % janë ndërtimet informale nga sasia totale e ndërtimeve të evidentuara, në mënyrë që të bëhej një përlogaritje e saktë e fondit limit për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi.

-Nuk kanë përcaktuar çmimin e analizuar në bazë të termave të referencave, sipas zërave përbërës të këtij shërbimi, nuk ka asnjë të dhënë për analizën e kostos, përqindjen e fitimit, apo qiraja e përdorimit të ambienteve në DR ALUIZNI Shkodër apo vëndodhje tjetër jashtë institucionit. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- Në praktikën e vënë në dispozicion mungonin dokumentet standarde të tenderit.

- Nuk kanë argumentuar dhe as dokumentuar në një procesverbal hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 61 të VKM nr. 914, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Kriteret për kualifikim të përcaktuara nga Njësia e Prokurimit nuk janë të plota dhe të qarta, disa prej tyre nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit dhe parimet për konkurrencën e lirë dhe transparencën në procedurat e prokurimit.

-Kanë vendosur kriterë jo të plota dhe diskriminuese, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik me qëllim shmangien e konkurrencës (përjashtimin e operatorëve që mund të plotësonin të gjitha kriteret e nevojshme ligjore, përveç këtyre kriterëve të padrejta) dhe favorizimin e operatorëve të ndryshëm ekonomik. Shkelja e rregullave, ka penguar lirinë e pjesëmarrjes dhe realizimin e barazisë së operatorëve ekonomik në këtë procedurë prokurimi, për të krijuar avantazhe favorizuese dhe të padrejta, si dhe për të eliminuar konkurrentet e padëshiruar pjesëmarrës në garë.

-Nuk kanë respektuar afatin ligjor për dorëzimin e ofertave prej 30 ditësh nga data e publikimit të kontratës në faqen e APP-së në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Kreu V, neni 43, pika 5. Në këtë mënyrë është bërë shmangia e konkurrencës duke sjellë pamundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, për shkak të moszbatimit të afateve kohore për dorëzimin e ofertave

II Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 9 punonjës si më poshtë:

1. J.N me detyrë Specialist Terreni,
2. N.M me detyrë Specialist Terreni,
3. N.V me detyrë Specialist Terreni,
4. I.K me detyrë Specialist Terreni,
5. A.T me detyrë Specialist Terreni,
6. K.SH me detyrë Specialist Terreni,
7. SH.K me detyrë Specialist Terreni,
8. N.V me detyrë Specialist Terreni,
9. E.P me detyrë Specialist Terreni.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- në 16 raste “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë

e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” i ndryshuar.

- në 7 raste nuk disponohet në dosje mos dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën ndërtimit dhe objekt papërfunduar**, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: - “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përfuar nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.” si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje.

- nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Shkodër nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI^t, Shkodër), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (brenda/jashtë vijës së verdhë), për efekt pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjese përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultojnë në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen-plan, planimetri)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, në 8 raste është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 1983 m² (në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 9,168,147 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve. etj.

III- Masa “Vërejtje me shkrim” për 2 punonjës si më poshtë:

1. Z.L me detyrë specialist,
2. S.S me detyrë specialist.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- në 16 raste “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” i ndryshuar.

- në 7 raste nuk disponohet në dosje mos dokumentacionin që të pasqyrojë periudhën e ndërtimit pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën ndërtimit dhe objekt papërfunduar, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: - “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përfutur nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.” si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje.

IV. Për 6 punonjës që janë aktualisht në marrëdhënie pune nuk propozojmë masë, pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirëfunksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë:, A.K, S. K, A.B, T.M, D.K dhe R.B.

D. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika “gj” e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik rast pas rasti* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal **për 5 punonjës**, si më poshtë:

1. **Z.A.D** ish/ Drejtorin e ALUIZNI-t nga data 23.06.2014 deri në datën 14.01.2016,
2. **Znj.E.B**, me detyrë Specialiste në cilësinë e Përgjegjës e Sektorit të Legalizimit në periudhën nga viti 2014 deri 04.10.2016,
3. **Znj.I.SH** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë Hartografisë nga viti 2015 e në vazhdim,
4. **Z.A.B** me detyrë specialist për çështjet e pronësisë dhe jurist i Njësisë së Prokurimit,
5. **F.T** me detyrë specialist, në cilësinë e Përgjegjës e Sektorit të Legalizimit

Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- Në 57 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi*:

-Në 1 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së lumit me pak se 100 metrash** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5. VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 4;

-në 13 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët nacionale e Urbane ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës rrugës nacionale e urbane me pak se përcaktimet ligjore** veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi”, -VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar Kreu I pika 2/b dhe i ç’fuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2;

-në 24 raste, gjithsej për 10791 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, pyll”, zona informale këto të pamiratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”

-në 1 raste objektet i legalizuara është aktualisht **me statusin e territorit publik**. Koncretisht - **dosja nr. 271, datë 04.08.2006; me** Leja e Legalizimit me nr. 87056, datë 06.02. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenet 27 dhe 41 koncretisht: neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit” pika d) Ku përcaktohet: -“*vërtetimin ose certifikatë ne pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. I njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin.*.”; neni 41 “Kriteret për legalizimin e shtesave” pika 2 dhe 3 ku përcaktohet:- “*2. Nuk legalizohen, në kuptim të këtij ligji, ndërtimet ose shtesat e ndërtimeve pa leje, të kryera brenda territoreve të shkollave dhe institucioneve të tjera publike.3. Asnjë ndërtim tjetër informal, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, nuk legalizohet brenda këtyre territoreve.*”.

-në 15 raste objektetet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Liqenit të Shkodrës** veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” ku përcaktohet:

Pika 2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe VKM me nr. 684, date 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”.

-në 3 raste objektet e legalizuara janë aktualisht **brenda zonës së mbrojtur të Lumit Buna, në dosje nuk ndodhet plani i menaxhimit të zonës dhe aprovimi i lejes mjedisore.** veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” ku përcaktohet:

Pika 2. Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e menaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit. Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj, zbatohet ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar. Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” si dhe VKM me nr. 682, date 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të lumit Buna terriore ligatinore përreth tij ” Pejsazh ujor/tokësor I mbrojtur”

-në 2raste konkretisht Leja e Legalizimit me nr. 92637 datë 06.10.2014 proceduesi P.M. D dhe Leja e Legalizimit me nr.94593 datë 25.04.2016 proceduesi A.G.G janë lëshuar në objekt të papërfunduar, veprime në kundërshtim me nenin 2 (pika 1) dhe 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime si dhe ligjit nr. 9720, datë 23,04,2007 i ndryshuar, VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu VI, pika 11 dhe13 .

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Drejtoria Juridike, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R